

**AKT
THEMELIMI I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

“Dynamic White” Shpk

Ortaku themelues:

Enrico Balbo nenshtetas italian, i biri i **Vittorio Balbo**, i datelindjes 07/11/1962, lindur ne Verona, Itali dhe banues ne Montagnola (CHE), Via Sabru 5, 6926, Zvicer, person madhor, me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i Kartes se Identitetit me nr. AS8485722.

me deshiren dhe vullnetin e tij te lire, ne perputhje me Ligjin nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, vendosi te krijojte nje shoqeri tregtare mbeshtetur ne dispozitat e meposhtme:

Neni 1

Shoqeria tregtare qe krijohet emerohet **“Dynamic White” Shpk**. Emertimi tregtar vendoset ne te gjitha aktet dhe dokumentat e shoqerise ne marredheniet me persona te trete, si dhe ne vulen zyrtare te saj.

Neni 2

Selia qendrore e shoqerise eshte ne Tirane ne adresen ne Rruga : “Mine Peza”, Hyrja 1, Apartamenti N/3, Zona Kadastrale 8350, Pasuria Nr.4/6-N/3. Selia qendrore e shoqerise mund te ndryshoje me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve Shoqeria ushtron veprimtarine e saj ne gjithe territorin e Republikes se Shqiperise apo edhe jashte saj, nepermjet degeve, filialeve, agjencive apo zyrave te perfaqesimit, kompetencat e te cilave percaktohen nga Asambleja e Ortakeve.

Neni 3

Shoqeria **“Dynamic White” Shpk** krijohet ne formen e “shoqerise me pergjegjesi te kufizuar” ne te cilen ortaku mbulon personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkuara sipas dispozitave qe parashikon ligji.

Neni 4

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte me afat te pakufizuar. Ky afat mund te ndryshoje me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve. Shoqeria fiton personalitetin juridik dhe mund te filloje veprimtarine e saj mbas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

Neni 5

Objekti i veprimtarise se Shoqerise tregtare “**Dynamic White**” Shpk. eshte:

Agjensi dhe /ose perfaqesuese tregtare ne lidhje me kategori te ndryshme te produkteve dhe ne vecanti ne lidhje me cdo produkt qe ka te beje me ndertimin, me arredimin e brendshem, sistemet e pastrimit, produktet ushqimore dhe jo ushqimore, si dhe tregjetimin e tyre. Konsulence per projektimin dhe per realizimin arkitektonik te arredimit. Blerje dhe dhënie me qira te pasurive te paluajtshme.

Neni 6

Kapitali i regjistruar i shoqerise eshte ne vleren 100.000 (Nje qind mije) leke. Kapitali i shoqerise eshte ndare ne 1 (nje) kuote (pjesë), me vlere 100.000 (Nje qind mije) leke. Nje kuote ka gjithashtu vleren e nje vote ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve.

Ne momentin e krijimit, kapitali i regjistruar i shoqerise eshte shlyer teresisht nga ortaku themelues i shoqerise dhe kuotat do te zoterohen nga ortaku i vetem :

- a) **Enrico Balbo**, zoterues i 100 % te kapitalit themeltar te Shoqerise ose 1 kuotë (pjesë) me vlere te pergjithshme 100 000 (Njeqind mije) Leke te shoqerise “**Dynamic White**” Shpk.

Neni 7

Organi me i larte drejtues dhe vendimmarres i shoqerise eshte Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve, e thirrur dhe mbledhur ne menyre te ligjshme, e cila perfaqeson teresisht teresine e ortakeve te shoqerise.

Kompetencat e Asamblese se Ortakeve percaktohen nga ligji dhe Statuti i Shqoqerise. Asambleja i ushtron kompetencat nepermjet vendimeve, qe merren prej saj sipas kuorumit te krekuar prej ceshtjes te caktuar, kourum, i cili percaktohet nga ligji dhe Statuti.

Neni 8

Shoqeria administrohet nga nje ose me shume administratore, me mandat 5 vjecar me te drejte riemerimi, te cilet edhe mund te mos jene ortake ne shoqeri. Nese Asambleja e pergjithshme emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne shoqerine ne menyre autonome.

Kompetencat e Administratoreve percaktohen nga ligji, Statuti ose aktet e tjera te brendshme te shoqerise.

Emerimi dhe shkarkimi i administratoreve behet nga Asambleja e Pergjithshme e

Ortakeve me shumice te zakonshme.

Neni 9

Shoqeria per ushtrimin e aktivitetit te saj krijon dhe disponon fondet e nevojshme, perfshire fondin rezerve dhe fonde te tjera per zhvillim. Perberja, madhesia, burimet e krijimit dhe perdorimi i çdo fondi ne perputhje me rrethanat, interesat dhe objektin e veprimtarise se shoqerise, vendosen nga Asambleja e Ortakeve duke respektuar legjislacionin ne fuqi.

Neni 10

Veprimtaria ekonomike e shoqerise ndahet ne periudha financiare 12 mujore. Viti financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 dhjetor te cdo viti kalendarik, me perjashtim te vitit te pare, i cili fillon nga data e krijimit te shoqerise dhe mbaron me 31 dhjetor.

Ne mbyllje te vitit financiar, ne perputhje me aktet ligjore ne fuqi, shoqeria harton dhe paraqet ne organet tatimore, bilancet financiare.

Administratori hartojn raportin mbi administrimin, gjendjen financiare, llogarite vjetore dhe inventaret e shoqerise, te cilat ja paraqesin per miratim Asamblese se Ortakeve brenda 6 mujorit te pare te viti pasardhes.

Neni 11

Veprimtaria e Shoqerise mbaron me vendim te Asamblese se Ortakeve ne rast se nuk eshte e mundur te realizohet objekti i veprimtarise se Shoqerise, ne rast se kjo veprimtari rezulton me humbje te vazhdueshme ose ne raste te tjera qe parashikon ligji.

Kur vendoset mbyllja e aktivitetit te shoqerise, ne çfaredo kohe dhe per çfaredo arsye, emerohet nje ose me shume likujdatore per te ndjekur dhe perfunduar procedurat e likujdimit ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Ne perfundim te procedurave te likujdimit, pasuria e Shoqerise qe mbetet pas shlyerjes se te gjitha detyrimeve ndaj te treteve, do te shperndahet ndermjet ortakeve ne perpjestim me pjesen e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar.

Neni 12

Si rregull, cdo mosmarreveshje ortaket do ta zgjidhin me mirekuptim midis tyre. Ne rast te kundert, kompetente oer zgjidhjen e tyre eshte Gjykata e rrethit gjyqesor Tirane.

Neni 13

Veprimtaria e shoqerise ne teresi do te rregullohet nepermjet Statutit dhe Akteve te tjera te brendshme te shoqerise si dhe Ligjit nr.9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe legjislacionin shqiptar ne teresi.

**ORTAKU I VETEM
I SHOQERISE TREGETARE
"Dynamic White" Shpk**

Enrico BALBO



Tirane me: 04 / 10 /2022